




DREJTORIA E ARSIMIT
DIREKCIJA OBRAZOVANJE
DIREKTORATE OF EDUCATION

DATA/DATUM/DATE	19.11.2021
NR/BR.	1356
PËR/ZA/TO	TABELËN E SHPALLJEVE
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Afrim Llabjani
NGA/OD/FROM	Sektorit të administratës së Drejtorisë së Arsimit
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Vendim për pranim në punë



Mbështetur në nenin 12, të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për Rregullimin Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Komisioni i Përzgjedhjes më datën 19.11.2021 nxjerr:

V E N D I M PËR SHPALLJEN E REZULTATEVE TË PRANIMIT SIPAS KONKURSIT

Komisioni i përzgjedhjes shpall rezultatet e pranimit të kandidatit për mësimdhënës sipas konkursit nr.1284 të datës 06.10.2021, të publikuar nga Drejtoria e Arsimit për vendet e punës: **Mësimdhënës për Lëndën e Tekstilil në SH.M. L "Zenel Hajdini" në Ferizaj**, pranohet kandidatja: Albulena Krasniqi me 81.0 % të pikëve të fituara, ndërsa në vendin e punës: **Mësimdhënës për Lëndën e Përpunimit të drurit**, pranohet kandidati: Ymri Lala me 77.6 % të pikëve të fituara.

Kandidatët tjerë kanë fituar më pak pikë.

A r s y e t i m

Në bazë të konkursit nr.1284 të datës 06.10.2021 të publikuar nga Drejtoria e Arsimit, për pranimin e kandidatit, për mësimdhënës, Komisioni përzgjedhës ka zhvilluar procedurat e intervistimit dhe vlerësimit sipas konkursit të lartëcekur.

Gjithashtu pas përfundimit të procedurave të vlerësimit të kandidatëve të cilët kanë aplikuar për vendin e lart cekur të punës, Komisioni Përzgjedhës ka marr vendim për shpalljen e rezultateve të pranimit të kandidatit i cili ka fituar më së shumti pikë, ndërsa kandidatët tjerë kanë fituar më pak pikë.

Nga të dhënat e shënuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Aplikuesi i pakënaqur me vendimin për përzgjedhje mund të ushtroj ankesë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankesa i drejtohet Komisionit të Ankesave për mes Zyrës së Personelit në Komunë.

DA, Ferizaj.